

Në zbatim të Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërit nr. 60 datë 5.4.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor” i ndryshuar, ASIG shpall konkurimin për vënd të lirë pune në pozicionin :

**- Shofer, Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme – (një pozicion pune).**

#### KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të mos ketë qenë i dënuar;
5. Të ketë arsim të mesëm;
7. Të ketë leje drejtimi automjeti, patentë të klasit C (minimumi);
8. Të ketë eksperiencë në përdorimin e automjetit, minimumi 5 vjet;
9. Të ketë aftësi komunikuese dhe aftësi për të punuar në grup.

Paga për këtë pozicion: është klasa – IV.

#### PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 20/12/2016 në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, në adresën: Godina e Inovacionit, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati II, Tiranë, ose në adresën e e-mailit [Info@asig.gov.al](mailto:Info@asig.gov.al), këto dokumenta:

1. Kërkesë për aplikim;
  2. CV;
  3. Fotokopje të diplomës;
  4. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
  5. Raport mjeko-ligjor;
  6. Kartë identiteti;
  7. Fotokopje e Librezës së punës;
  8. Kopje e Lejes së Drejtimit.
  9. Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar.
- (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, kualifikimin dhe aftësitë të kandidatit.

Pas verifikimit paraprak të aplikimeve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor do të njoftohen konkurrentët e kualifikuar, si dhe data kur do të zhvillohet intervista.

